

PRISHTINA REA Background

Prishtina REA është një Agjenci konsulente, e themeluar me iniciativë të Agjencionit Evropian për Rindërtim (AER) në vitin 2001 si pjesë e Programit të Integruar Zhvillimor të Unionit Evropian për sektorin privat në Kosovë.

Prishtina REA ka për qëllim të ofroj në mënyrë efektive dhe profesionale këshilla biznesi dhe shërbime trajnimesh dhe konsulencash biznesi për NVM-të dhe ndërmarrësit, fillestarët në biznes, të papunët, institucionet qeveritare lokale dhe qendrore, si partner implementues i projekteve ndërkombëtare në fushën e zhvillimit ekonomik dhe si promotor i iniciativave për Zhvillim Ekonomik Regjional dhe promovim të Sektorit Privat, në vend dhe jashtë vendit.

Deri më tash, Prishtina REA ka implementuar më shumë se 50 projekte anë e mbanë Kosovës, për të gjitha grupet etnike; trajnime, shërbime këshillimore dhe konsulence, studime, kërkime tregu, asistencë teknike për themelim dhe ristrukturim të Asociacioneve, shoqatave dhe kooperativave bujqësore, Asociacioneve të grave, të të rinjëve, të bizneseve, të kompanive të ndërtimit të rrugëve etj. Tashmë, ne i kemi 9 punëtorë të rregulltë dhe 14 bashkëpunëtorë profesionalë. Në mesin e tyre, ne kemi staf me shumë përvojë dhe me arsimim prej Prof. Dr deri në diplomë fakulteti, (tre janë prof. Dr, një Mr, një specialist, dhe të tjerët me diplomë fakulteti). Për momentin, ne kemi më shumë se 190 trajnime të ndryshme të gatshme, të hartuara nga ne, shumica e tyre të ofruara tregut tonë kosovar.

Ne kemi punuar me shumë partner vendi dhe të jashtëm: CIDA, European Perspective, World Vision, LWF, IRC, UMCOR, USAID-KBS-Save the Children, CECI, SEED, CARE Int, UNOPS- ABU/EAR, KWI, DIWI, PVPT Association, OSCE, USAID/KCBS-KAMP, SHPUK, BAS/EAR etc.

Prishtina REA është anëtare e shumë Konsorciumeve ndërkombëtare për Zhvillim Ekonomik Lokal dhe promovim të sektorit privat.

Misioni i Prishtina REA ËSHTË PËRKRAHJA, PROMOVIMI DHE ASISTENCA PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK TË KOSOVËS

Poashtu, Prishtina REA, tashmë tre vjet është partner vendor i Junior Achievement Worldwide, duke operuar si **Junior Achievement Kosova**, dhe duke ofruar programe edukimi në **Ndërmarrësi** për shkollat fillore, të mesme dhe te fakultete.

Deri me tash ne kemi përgatitur shtatë programe të ndryshme dhe kemi punuar me më shumë se 40 shkolla të ndryshme në gjithë Kosovë, duke pasur edhe një MoU me MASHT.

PRISHTINA REA

Ahmet Jetullahu Meti- Director of Prishtina REA
Mob:044 173 581 - 038 244 951 email: prishtinarea@yahoo.com

www.prishtina-rea.net

INICIATIVA E PRISHTINA REA – INTERNSHIP

Në mënyrë që të mbështesim sa më shumë edukimin, punësueshmërinë, të kontribuojmë në aftësimin e të rinjëve për tregun e punës, ne jemi të gatshëm të ofrojmë një pozitë Internship, çdo muaj për studentë të ndryshëm me preferencë ndaj studentëve të ekonomikut (UP) afër/në prag të diplomimit. Mund të jenë alternativë edhe studentët nga Ekonomiku. Internship-Studentët zakonisht do të jenë pjesë e ekipeve tona implementuese të projekteve të ndryshme të Prishtina REA.

Prishtina REA, poashtu do të ofroj edhe një kompenzim prej 125€për muaj/student.

Meti
Prishtina REA

PRISHTINA REA

Ahmet Jetullahu Meti- Director of Prishtina REA
Mob:044 173 581 - 038 244 951 email: prishtinarea@yahoo.com

www.prishtina-rea.net